



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01- Nr 020/09- 98237 dt. 05.11 2020

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 21 të Rregullores Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e komisionit për vlerësimin e Pasurive Jo Financiare në sektorin e Arsimit

- I.** Me këtë Vendim emërohen anëtarët e komisionit për vlerësimin e Pasurive Jo Financiare në sektorin e Arsimit në këtë përbërje:
1. Bejzë Bytyqi (Kryetar),
 2. Armend Cakiqi (Anëtarë),
 3. Emin Isufi (Anëtarë),
- II.** Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit për vlerësimin e pasurisë jo financiare janë si në vijim:
- Vlerësimi i pasurive të dëmtuara;
 - Vlerësimi i kërkesave për tjetërsimin e pasurisë;
 - Prezantimi i dëshmive për vlerësimin e pasurisë;
 - Përgatitja e raportit për pasurinë jo financiare që duhet të largohet nga përdorimi.
- III.** Vlerësimi për nxjerrjen jashtë përdorimit të pasurisë jo financiare duhet të bazohet në kriteret si vijon:

- Kalimi i kohës së përdorimit në bazë të shkallës së zhvlerësimit, afatit të skadimit, dhe pamundësisë për riparim;
- Pamundësia për riparim si pasojë e konsumit dhe mos përshtatjes në përdorim tjetër;
- Shkalla e dëmtimit e cila nuk lejon në kthimin në gjendjen e mëparshme;
- Vlera më e madhe apo e barabartë e riparimit me vlerën e tregut të pasurisë jo financiare;
- Pamundësia e përdorimit të pasurisë jo financiare për qëllime të caktuara si pasojë e ndryshimit të kërkesave teknike, kushteve të punës dhe fushëveprimit të organizatës buxhetore.

IV. Komisioni fillon punën me rastin e pranimit të këtij Vendimi.

V. Komisioni duhet të raportoj para datës 15.01.2021, gjegjësisht para hartimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin fiskal 2020. Raporti përfundimtar i nënshkruar duhet t'i dorëzohet ZKA-së, ZKF-së dhe Drejtorit për Buxhet dhe Financa.

VI. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Personelit;
- Anëtareve të Komisionit;
- Z. Kushtrim Bajraktari;
- Znj. Fluida Nika;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.